


Tregtia e jashtme e mallrave

Korrik 2021

Tiranë, më 17 Gusht 2021: Në Korrik 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 32 mld lekë, duke u rritur me 30,6 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe ulje me 7,9 %, në krahasim me Qershor 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, eksportet në muajin Korrik 2021 u rritën me 21,7 %. Importet e mallrave arritën vlerën 72 mld lekë, duke u rritur me 26,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 6,6 %, në krahasim me Qershor 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, importet në muajin Korrik 2021 u rritën me 22,9 %. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 39 mld lekë, duke u rritur me 22,6 %, krahasuar me Korrik 2020 dhe me 22,2 %, në krahasim me Qershor 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, defiçiti tregtar në muajin Korrik 2021 u rrit me 23,9 %.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në shtatëmujorin e parë 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 209 mld lekë, duke u rritur me 39,2 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 426 mld lekë, duke u rritur me 29,8 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 217 mld lekë, duke u rritur me 21,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Korrik 2021, në rritjen e eksporteve prej 30,6 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +13,2 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +7,5 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +3,4 pikë përqindje. Ndërsa grupi “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” ka ndikuar negativisht me -0,03 pikë përqindje.

Gjatë muajit Korrik 2021, rritja e eksporteve prej 21,7 %, krahasuar me mesataren mujore të tre viteve (2018-2020), është ndikuar nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +10,7 pikë përqindje, Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +5,4 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +3,6 pikë përqindje. Ndërsa grupi “Tekstile dhe këpucë” ka ndikuar negativisht me -4,3 pikë përqindje.

Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Korrik 2021




Eksportet, gjatë këtij shtatëmujori janë rritur me 39,2 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +13,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +12,3 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +5,4 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Korrik 2021, në rritjen e importeve prej 26,1 %, krahasuar me Korrik 2020, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +5,8 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +5,0 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +4,6 pikë përqindje.

Gjatë muajit Korrik 2021, rritja e importeve prej 22,9 %, krahasuar me mesataren mujore të tre viteve (2018-2020), është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +6,2 pikë përqindje, Ushqime, pije, duhan” me +4,0 pikë përqindje dhe “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +3,4 pikë përqindje”. Ndërsa grupi “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” ka ndikuar negativisht me -0,3 pikë përqindje.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Korrik 2021



Si shtatëmujor, importet janë rritur me 29,8 %, krahasuar me shtatëmujorin e parë 2020. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +8,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,8 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +4,4 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Korrik 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Korrik 2020 janë: Italia (15,1 %), Kosova (17,9 %) dhe Spanjë (44,1 %). Ndërsa vendi me të cilin eksportet kanë pasur uljen më të madhe është: Kina (15,7 %).

Gjatë këtij shtatëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë janë: Italia (29,0 %), Kosova (56,8 %) dhe Spanja (40,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Mbretëria e Bashkuar (7,8 %) dhe Ukraina (30,5 %).

Në muajin Korrik 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Korrik 2020 janë: Italia (16,5 %), Turqia (14,2 %) dhe Kina (16,8 %). Ndërsa vendet me të cilët importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kroacia (11,8 %), Zvicra (27,4) dhe Austria (12,2 %).

Gjatë këtij shtatëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë janë: Italia (34,4 %), Turqia (48,3 %) dhe Kina (31,0 %). Ndërsa vendet me të cilët importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Rusia (8,6 %), Zvicra (25,5) dhe Ukraina (16,8 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Korrik 2021



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 59,9 %, të gjithë tregtisë. Në Korrik 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 53,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,0 %), Greqia (7,3 %), Turqia (7,1 %) dhe Gjermania (6,7 %).

Shkëmbimet tregtare, për shtatëmujorin e parë 2021, me vendet e BE-së zënë 61,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Korrik 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 56,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,2 %), Turqia (7,8 %), Greqia (7,1 %) dhe Gjermania (6,6 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Korrik 2021

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2018	07 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	Janar– Korrik 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
2019	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	Janar– Korrik 19	180	-2,6	377	2,6	-197	47,7
2020	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	Janar – Korrik 20	150	-16,7	328	-13,1	-178	45,7
2021	07 - 21	32	30,6	72	26,1	-39	44,8
	Janar– Korrik 21	209	39,2	426	29,8	-217	49,0

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Korrik 2021

	Eksporte				Importe			
	Korrik 2020	Korrik 2021	Janar-Korrik 2020	Janar-Korrik 2021	Korrik 2020	Korrik 2021	Janar-Korrik 2020	Janar-Korrik 2021
Vendet e BE-së	18.530	23.599	113.205	151.679	33.705	38.532	189.564	238.316
Austri	65	226	832	1.361	596	523	2.986	3.681
Gjermani	1.182	1.777	9.437	11.287	3.961	5.129	25.025	30.759
Greqi	1.237	2.028	6.940	12.055	4.830	5.590	30.087	32.695
Itali	11.775	13.549	68.873	88.829	15.089	17.574	81.102	108.989
Spanjë	1.554	2.239	9.992	14.015	898	1.121	5.220	6.196
Kroaci	86	184	1.017	1.667	901	794	3.735	4.380
Të tjera të BE-së	2.632	3.596	16.114	22.464	7.430	7.799	41.409	51.615
Mbretëri e Bashkuar	26	109	453	418	456	798	2.862	3.627
Kinë	373	314	2.962	4.130	5.410	6.316	28.550	37.387
Kosovë	2.643	3.117	12.986	20.368	861	1.548	4.424	6.680
Maqedonia e Veriut	678	1.129	4.567	6.881	903	1.082	4.989	5.697
Rusi	-	-	6	8	948	1.040	8.917	8.153
SHBA	179	637	1.636	2.762	680	4.040	4.974	10.187
Turqi	225	586	1.325	3.614	5.932	6.772	30.951	45.915
Ukrainë	19	36	289	201	155	264	2.534	2.108
Zvicër	45	175	461	1.517	886	643	6.173	4.599
Të tjera	1.849	2.390	12.057	17.145	6.830	10.542	44.169	63.119
Gjithsej	24.567	32.093	149.947	208.723	56.767	71.578	328.106	425.787

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Korrik 2021

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Korrik 2020	Korrik 2021	Jan, - Korrik 2020	Jan, - Korrik 2021	Korrik 2020	Korrik 2021	Jan, - Korrik 2020	Jan, - Korrik 2021
Gjithsej	24.567	32.093	149.947	208.723	56.767	71.578	328.106	425.787
Ushqime, pije, duhan	3.392	3.906	21.892	25.301	9.590	12.186	63.535	69.971
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	3.524	5.360	21.997	40.373	4.221	7.492	29.058	38.893
Produkte kimike dhe plastike	659	1.158	4.018	5.879	8.315	10.182	50.252	64.667
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	180	172	1.229	1.480	1.193	1.248	7.263	8.527
Prodhime druri dhe letre	749	896	4.692	4.991	2.110	2.394	12.924	15.133
Tekstile dhe këpucë	9.846	10.050	58.111	66.269	7.386	7.673	40.020	50.439
Materiale ndërtimi dhe metale	3.857	7.090	21.243	41.941	7.551	9.028	44.500	60.317
Makinëri, pajisje dhe pj, këmb,	1.552	2.381	12.180	16.418	13.965	16.796	68.335	97.638
Të tjera	808	1.079	4.586	6.070	2.435	4.579	12.218	20.204

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Korrik 2021

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Gjithsej	68.873	88.829	12.986	20.368	9.992	14.015	6.940	12.055
Ushqim, pije duhan	5.041	6.184	2.308	2.655	687	883	1.648	2.129
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	729	1.010	2.055	4.894	8.567	12.707	424	4.011
Produkte kimike dhe plastike	1.113	1.553	1.188	1.768	73	19	304	449
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.052	1.031	3	11	71	2	9	9
Prodhime druri dhe letre	2.776	3.340	442	455	2	58	779	762
Tekstile dhe këpucë	43.215	52.088	66	112	474	260	2.857	3.066
Materiale ndërtimi dhe metale	6.953	12.363	5.555	8.761	89	74	689	1.257
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	6.080	8.410	429	843	10	11	29	61
Të tjera	1.914	2.851	941	869	19	2	201	310

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Korrik 2021

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
Gjithsej	81.102	108.989	30.951	45.915	28.550	37.387	30.087	32.695
Ushqim, pije duhan	11.165	13.449	3.198	4.001	398	544	9.399	9.440
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	2.629	6.113	1.693	3.228	4	9	5.470	4.793
Produkte kimike dhe plastike	10.618	13.656	4.840	6.260	3.146	5.629	4.476	5.427
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	5.926	7.033	129	197	289	404	19	21
Prodhime druri dhe letre	3.322	3.567	1.649	1.797	440	415	1.960	2.188
Tekstile dhe këpucë	18.317	24.298	8.128	9.948	4.956	6.456	2.055	2.005
Materiale ndërtimi dhe metale	9.650	14.422	5.964	11.374	3.798	3.002	4.208	5.770
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	16.828	22.576	4.314	6.230	12.635	17.385	1.689	1.940
Të tjera	2.647	3.876	1.037	2.881	2.884	3.544	812	1.111

Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv,

Vlera F,O,B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues,

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor,

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat,

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore,

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci,

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri